REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

Durrës 17.08.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë si mëposhtë vijon:

Në lagjen numër 5 të njësisë administrative numër 3 sipas informacioneve të Bashkisë Durrës për Faktoje janë në total 9 pallate me shkallë dëmi DS5.

- Sa prej këtyre pallateve janë shembur?

Aktualisht për objektet e dëmtuara nga tërmeti me nivel dëmi DS5, me buxhetin e Bashkisë Durrës është parashikuar rindërtimi i godinës nr.32, "Fakle", rruga "Teodor Rupi", I ndodhur në njësinë administrative nr.3 Durrës, objekt i cili është në fazë rindërtimi.

- Sa prej këtyre pallateve janë rindërtuar deri tani?

Në njësinë nr. 3 është rindërtuar deri tani vetëm pallati nr. 30 rruga "Hysen Myshketa".

- Ku gjendet secili nga këto 9 pallate (emri i rrugës dhe numri i pallatit nëse ka)?

Nuk jane me 9 pallate po jane 7. Adraset e tyre jane si me poshte:

Nd 11 rruga Kadri Pirro L.5

Nd 25/1 rruga Hysen Myshketa

Nd 7 rruga Edit Durham

Nd 13 rruga Edit Durham

Nd 8 rruga Stefan Dhima

Nd 32 rruga Teodor Rupi

Nd 32 rruga Hysen Kertusha

- Kur kanë përfunduar këto pallate të rindëruar?

Në lidhje me këtë pikë zyra e rindërtimit nuk ka dijeni se kur ka përfunduar ndërtimi i pallatit nr.30 rruga "Hysen Myshketa".

- A kanë hyrë familjet në pallatet e rindërtuara dhe kur?

Familjet e pallatit nr.30 rruga "Hysen Myshketa" kanë hyrë, referuar procesverbalit të shorteut të mbajtur në datën 10.11.2023.

- Sa janë familjet që janë strehuar në pallatet e rindërtuar në këtë lagje?

Në pallatin nr.30 rruga "Hysen Myshketa" janë strehuar 32 familje.

- A ka nisur rikonstruksioni i pallatit te sportit "Ramazan Njala"?

Ky objekt eshte i parashikuar ne buxhetin e vitit 2026 , te miratuar me VKB nr. 73, date 23.12.2025 dhe eshte planifikuar qe te finanacohet ne 2 vite, 2026-2027

- A ka një afat për realizimin e këtij rikonstruksioni?

Për rikonstruksionin e pallatit të sportit "Ramazan Njala", ky investim është parashikuar të realizohet me faza, dhe fondet për realizimin e tij janë miratuar në buxhetin e Bashkisë Durrës, dhe më tej parashikohet të kryehet dhe proçedura e prokurimit publik për këtë investim.

3. Cila është faza aktuale e punimeve për Parkun Urban në Spitallë, sa % e tyre janë realizuar deri tani (korrik 2026)?
3.1. A ka ndonjë vonesë apo devijim nga plani fillestar?
3.2. A janë kryer pagesat ndaj zbatuesit të projektit (FSHZH) sipas planit financiar të parashikuar? Nëse po, sa është shuma e disbursuar deri më tani?
3.4. Cilat janë komponentët kryesorë të parkut që janë përfunduar dhe cilat janë në proces ndërtimi? Për shembull: gjelbërimi, hapësirat për fëmijë, ndriçimi, mobilimi urban, rrjetet inxhinierike, etj.
3.5. Kur parashikohet të përfundojë ndërtimi i Parkut të Spitallës?

Për këto pika duhet ti drejtoheni FSHZH-së, në cilësinë e investitorit të këtij investimi.

- Cila është faza aktuale e projektit për rikonstruksionin e Teatrit "Aleksandër Moisiu" në Durrës, deri në korrik 2026?

Përsa i përket objektit "Rikonstruksion i Pallatit të Kulturës" për këtë objekt fillimisht është lidhur kontrata e parë për punë publike afati I së cilës ka përfunduar gjatë periudhës qershor-korrik, ndërkohë është nënshkruar dhe Amendamenti (shtesë kontrate) për modifikimin e kontratës fillestare për punë publike nr.3327/11 prot datë 08.11.2024 me objekt "Rikonstruksion i pallatit të Kulturës" ku vlera e këtij amendamenti është 69,990,470 lekë me tvsh, me afat 5 mujor.